



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNALI KOMUNAL / SIVBY OF MUNICIPALITY SKUPSTINA OPŠTINE SKENDERAJ
Nr.
No. 02-350/01-0010760/24
Data.
Data. 22.02.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 5 shkronja d), nenit 17, nenit 58 shkronja a) dhe c), të Ligjit për Vetqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 21 nenit 60 të Ligjit për Proceduren e Përgjithshme Administrative 05/L-031, në përputhje të plotë me nenin 39, paragrafi 2 dhe paragrafi 5, nënparagrafi 5.1, të Udhëzimit Administrativ MMPH-nr. 24/2015, Harten Zonale të Komunës së Skenderajt nr. 01-350/01-0055085/20 të dt. 29.12.2020, në përputhje me objektivat, qëllimet, vizionin dhe strategjitë e Planit Zhvillimor Komunal, Statutit nr.Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008 të Komunës së Skenderajt, sipas kërkeses nr.06-350/02-0008637/24 të datës 07.02.2024 me datë 22.02.2024 lidhet kjo:

MARRËVESHJE

ZHVILLIMI

Ndërmjet:

1. **Komunës së Skenderajt**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës **z.Fadil Nura** me adresë rr."28 Nëntori" Skenderaj,(në tekstin e mëtejme Komuna), dhe
2. **Kompanisë "EL TECH KOSOVA GROUP" SH.P.K**, me pronar **z.Faik Hasani**, nga Skenderaj (në tekstin e mëtejme aplikuesi).

Neni 1
Lënda

Lëndë e kësaj marrëveshje është përcaktimi i bonuseve të zonimit të parapara në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Skenderajt nr. 01-350/01-0055085/20 të dt. 29.12.2020 të ofruara për aplikuesin si mjet stimulimi që e shfrytëzon Komuna e Skenderajt në këmbim për realizimin e përfitimit publik projekti me titull: "Ndërtimi i Tregut të Gjelbert në Qytet", (i projektuar nga Kompania "Armiring SH.P.K. & ENGGROUP" SH.P.K. - Malishevë).

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje zhvillimi është pajtueshmeria mes palëve me qëllim të përcaktimit të bonuseve të sakta të zonimit (stimulimeve) të cilat i pranon (aplikuesi) për realizimin e përfitimit publik të Komunës së Skenderajt projekti me titull: "Ndërtimi i Tregut të Gjelbert në Qytet".

Neni 3 Obligimet e aplikuesit

- 3.1.** Obligohet të financoj Tregun e Gjelbert në Qytet, bazuar në projektin e paraparë nga kompania "Armiring SH.P.K.&ENGGROUP" SH.P.K. - Malishevë, në vlerë prej **43.441,74€**.
- 3.2.** Aplikuesi obligohet që të respektoj planin dinamik të paraparë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit si organ profesional.
- 3.3.** Obligohet të bëjë respektimin e obligimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, përndryshe bonuset e zonuese që i ofron komuna në këmbim të realizimit të projektit nga neni 1 do të konsiderohen Nule (shfuqizohen-terhiqen), dhe pagesa e lejes për bonus nuk mund të kthehet.
- 3.4.** Aplikuesi merr përsipër të siguroi (ofroi) Komunës zhvillimin e projektit të cekur në nenin 1 të kësaj marrëveshje, në këmbim të bonusit të zonimit që i ofron Komuna.
- 3.5.** Në rast të mos përmbushjes së detyrimit sipas paragrafit **3.1** të këtij neni për realizimin e projektit të Komunës, kjo marrëveshje është absolutisht e pavlefshme

Neni 4 Obligimet e Komunës

- 4.1.** Komuna merr përsipër që në këmbim të ndërtimit të Tregut të Gjelbert në Qytet bazuar në projektin e paraparë nga Kompania "Armiring SH.P.K. & ENGGROUP" SH.P.K. – Malishevë, t'i ofrojë aplikuesit:
-bonus zonimi me koeficient nga **3 në 3,671** me sipërfaqe prej **646.20 m²**, si dhe pjesa e mbetur prej **72m²** e sipërfaqes së pronës të Ilogaritit në kuadër të koeficientit, e për të cilën posedon Lejen Ndërtimore nr.06-351/02-0053712/23 të datës 26.10.2023 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, në parcelën 01057-1 me sipërfaqe prej 572m² dhe parcelën 01057-2 me sipërfaqe prej 326m².
- 4.2.** Për mbikëqytjen e realizimit të projektit nga aplikuesi dhe përmbushjen e obligimeve të Komunës sipas këtij neni do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit të Komunës së Skenderajt si organ profesional për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Neni 5 Plotësimi-Ndryshimi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Kjo marrëveshje mund të ndryshohet, plotësohet dhe zgjidhet me marrëveshje, mirëkuptim dhe me pëlqim të paleve nënshkruese të saj, ku çdo ndryshim i saj duhet të bëhet me njoftim paraprak, në të shkruar, dhe të integrohet brenda kësaj marrëveshje me një ankes-marrëveshje dhe të nënshkruhet nga të dyja palët, në rast të mosarritjes për zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhje të mosmarrëveshjeve është Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj.

Neni 6
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe kopjet


- 6.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët nënshkruese, dhe do të zgjasë deri në përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në nenet më lartë, ndërsa pas përfundimit të projektit në tërësi do të shërbej vetëm si dokument dëshmues mbi realizimin e përfitimit publik.
- 6.2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në katër (4) ekzemplarë të njëjtë, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Palët nënshkruese:
Me 22.02.2024

Komuna e Skenderajt


z.Fadil Nura, Kryetar

“El Tech Kosova Group” SH.P.K.


z.Fajl Hasani, pronar